

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ROI Academy L.L.C SH.P.K**

Sot, më datë 16/01/2023 (dymije e njezete e tre), u paraqiten personalisht:

THEMELUESI:

Arb ABDYLI, atësia Kastriot, amësia Venera, shtetas Kosovar, lindur në Prishtinë dhe banues në PRISHTINË, me adresë Rr: Arben Xheladini, Nr:30, Prishtinë, lindur më 04/11/1999, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit Pasaporte Nr.PO2171893 leshuar nga shteti KOSOVË (RKS) date 16.06.2022 dhe date skadimi 15.06.2032.

Palet kerkojne te themelojne një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar bazuar ne Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si me poshte:

**TITULLI I
EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA – KOHEZGJATJA
NENI 1
Emri i Shoqerise**

1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria **ROI Academy L.L.C**, ne vijim referuar si “Shoqeria”.

1.2 Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

NENI 2

Regjimi Juridik i Shoqerise

2.1 **ROI Academy L.L.C** është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj është i organizuar sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil në Republikën e Shqipërisë.

2.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë regimin e saj juridik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe dispozitat e Statutit të saj.

2.4 Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

NENI 3

Selia

3.1 Shoqeria ka seline e saj ne adresen: **Rruga Haxhi Hysen Dalliu, Hyrja 1, Nr.Pasurie 5/574+1-6, zk.8350, Vol.29, Fq.7, Tirane, Shqiperi.**

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë, filiale dhe / ose zyra përfaqësimi brënda Shqipërisë dhe / ose jashtë vendit, ose të krijojë shoqëri të tjera me Partnere apo Aksionarë pjesëmarrës.

**NENI 4
Kohezgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerisë në Regjistrin Tregtar. Ortaku/ët e Shoqerisë mund të vodosin të kufizojnë kohëzgjatjen e aktivitetit me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**TITULLI II
OBJEKTI
NENI 5**

A. A

Fq. 1

Objekti

5.1 Objekti kryesor i Shoqerise do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në veprimtaritë e mëposhtme:

1. Ofrimin e trajnime ne fushat e teknologjise se informacionit, por jo vetem
2. Ofrimin e trainimeve ne fushen e marketingut, por jo vetem
3. Ofrimin e trainimeve ne fushen e dizainit, por jo vetem
4. Ofrimin e trainimeve ne fushen e programimit, IT-se e teknologjise se informacionit, por jo vetem
5. Organizime dhe menaxhime aktivitetesh per dite te rendesishme, seminare, konferanca si dhe investime në projekte te ndryshme me qellim perfitim ekonomik.
6. Perfaesi kompanish te huaja ne Shqiperi.
7. Pergatitje te ambjenteve per organizime te tilla apo te ngjashme. Organizime eventesh, workshop, reklama, evenete mediatike, etj. Tregti me pakice te produkteve ushqimore dhe pijeve alkoolike dhe jo alkoolike. Tregti te produkteve promocionale.
8. Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.
9. Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitetet te tjera shtese, me qellim permibushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjisacionin shqiptar ne fuqi.
10. Çdo aktivitet tjeter tregtar qe lidhet ne menyre te drejtoperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.

TITULLI III

KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 6

Kapitali i Shoqerise

6.1 Kapitali i shoqerisë është në vlerën 100'000 LEK (njëqindmijë lekë) i ndare në 1 (një) kuotë.

Kapitali i shoqerise eshte paguar plotesisht nga ortaku themelues si më poshtë vijon:

a) **Arb Abdyli**, nënskrues i 1 (nje) kuote, që perfaqeson 100 % të kapitalit të shoqërisë, me një vlerë prej 100'000 Lek (njëqindmijë lekë).

6.2 Kontributi i ortakut themelues mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

6.3 Pergjegjesia e Ortakut Themelues ndaj palëve të treta për detyrimet e marra përsipër nga kompania është e kufizuar sipas pjesëmarries së tij në kapitalin e shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave të shoqërisë ndaj palëve të tretë i nënshtronhet së drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë sipas kushteve të percaktuara në nenin 7.2 deri në nenin 7.6 më poshtë.

7.2 Ne rast se një ortak "Ofruesi" kërkon të shesë dhe/ose të transferoje disa ose të gjitha kuotat e tij, Ortaket e mbetur do të kenë të drejtën e parablerjes në lidhje me kuoten që ofrohen për transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve të mëposhtme:

(a) Ofruesi do tu dergojë fillimisht ortakëve të mbetur një njoftim me shkrim i cili përcakton përqindjen e kuotës së ofruar, cmimin dhe kushtet e tjera të transferimit, duke ftuar së pari Ortakët e mbetur të blejnë aksionet e ofruara;

(b) Ortaket mbetur do të kenë të drejtën të blejnë kuotat e ofruara përpjestimisht dhe sipas kushteve te ofertës, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një afati prej tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së njoftimit të Ofruesit.

7.3 Ne rast se më shumë se një prej Ortakëve të mbetur dëshirojnë të blejnë kuotën e ofruar, secili prej ketyre ortakëve të mbetur do të ketë të drejtën të blejë kuotën e ofruar përpjestimisht sipas përqindjeve që zoterojnë në Shoqëri, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brënda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga marrja e njoftimit sipas së cilit secili prej tyre dëshiron të bleje kuotën e ofruar.

7.4 Ne rast se asnje nga ortaket e mbetur nuk deshiron te bleje kuoten e ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejne kuoten e ofruar dhe/ose nuk jane perqindjen brenda tridhjete diteve nga marrja e ketij njostimi, Ofruesi do te kete te drejten ti transferoje Kuotat e ofruara nje pale te trete me te njetin cmim qe i eshte ofruar ortakeve te mbetur (sipas kushteve te ofertes fillestare). Nese ky kusht nuk eshte permbushur, Marreveshja per Shitjen e Kuotave me palet e treta do te jete e pavlefishme.

7.5 Ne rast se ndonje ose te gjithe ortaket e shoqerise blen/blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, sic percaktohet me siper, ky transferimi do te kryhet sipas kushteve te ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara me siper nuk do te zbatohen ne rast transferimi te kuotave nga nje ortak tek nje shoqeri e cila ndodhet nen kontrollin e ketij ortaku ose ne rast transferimi nga nje ortak tek nje pasardhes ose pasardhes i drejperdrejte i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e neneve 7.1- 7.6 , nuk do te zbatohen ne rast transferimi te bere ne favor te nje ose disa ortakeve te tjere. Megjithate, ne kete rast transferimi duhet ti komunikohet fillimisht te gjithe ortakeve. Te gjitha njostimet sipas ketij neni duhet ti dergohen edhe Shoqerise.

Neni 8

Rritja e Kapitalit

8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te rrise kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Ne rast te nje rritje te kapitalit, ortaket kane te drejte te nenshkrimit te kuotave nepermjet kontributit ne natyre ose ne te holla, ne proporcione perqindjen qe gezojne ne kapitali e shoqerise.

8.3 Nese ndonje nga ortaket refuzojte te drejten nenshkrimit, kapitali mund te nenshkruhet nga ortaket e tjeter. Ne kete rast, ortaket e tjere mund te ushtroje te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcione perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 9

Zvogelimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Ne qdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

9.2 Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcione me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

Neni 10

Certifikata e pjesemarrjes

10.1 Secili nga ortaket gezon te drejten nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotata e mbajtura se bashku nga disa Ortake dhe shperndarja e certifikates per perfaquesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjithe ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.

TITULLI IV ORGANET E SHOQERISE

Neni 11

Organet e Shoqerise

11.1 Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Administratori / s.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e Pergjithshme

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithe Ortaket e Shoqerise.

11.2 Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe te votuje ne baze te kuotave qe zoteron.

A. A

11.3 Ortaku mund te perfaqesohet nga një person tjeter, jo domosdoshmerisht Ortak/e, me ane te një Prokure te Posacme. Ne çdo rast, kjo Prokure e Posacme mund te jepet vetem per një Mbledhje te caktuar te Asamblese se Pergjithshme, dhe do te jetë e vlefshme edhe per mbledhjet pasardhese me te njejtin rend dite. Administratoret nuk mund te perfaqesojne Ortakun ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne një vend te ndryshem nga selia e Shoqerise, ne Republiken e Shqiperise ose jashte vendit.

11.5 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave te Shoqerise ose nese kerkohet nga legjislacioni ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret edhe nga cdo Ortak qe zoteron te pakten 10% (dhjete per qind) te pjeses se kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten një here ne vit, brenda javes se fundit te muajit Maj, ne menyre qe te diskutoje, te shqyrtoje dhe te miratoje bilancin vjetor te vitit te kaluar fiskal. Mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme, do te mbahet brenda tre muajve nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar per te diskutuar planin e biznesit dhe çeshtje te tjera.

11.6 Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme do te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, dhe do te dergohet ne adresat e Ortakeve te shoqerise te regjistruara ne Regjistrin e Ortakeve, ose me poste elektronike ne adresat e Ortakeve, ose me poste tek Ortaket se paku 21 (njezet e nje) dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

11.7 Njoftimi duhet te permbate informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen ne rendin e dites dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrijes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyra e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.

11.8 Asambleja e Pergjithshme do te konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nese nuk ka ndjekur te gjitha formalitetet te thirrjes, nese te gjithe Ortaket qe perfaqesojne pjesen e tere kapitalit te shoqerise jane te pranishem ne mbledhje apo te perfaqesuar nga një perfaqesues me prokure te posacme, dhe shprehen dakort per te zhvilluar mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullisive ne thirrjen e saj.

11.9 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarjen e njerezve ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet permes telekonferencies apo videokonferencies, ose mjete te tjera te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithe pjesemarresit te mund te identifikohen dhe t'i jepet mundesa per te marre pjese ne diskutimet dhe per te marre pjese ne to.

11.10 Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emerohet nga radhet e Ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje. Nese prezenca e nje noteri publik nuk eshte e nevojshme, Asambleja e Pergjithshme do te emeroje nje sekretar, i cili nuk duhet te jete domosdoshmerisht nje nga Ortaket.

11.11 Kryetari i Mbledhjes ka kompetencia te plota per te kontrolluar prokurat e posacme dhe rregullsine e tyre, te drejten e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, si dhe per te percaktuar nese Mbledhja eshte thirrur rregullisht dhe nese kuorumi i nevojshem per marjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per te percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

11.12 Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe ka fituar Kuotat e Ortakeve te tjere me ane te nje procesi ligjor dhe zoteron tere kapitalin e shoqerise, vendimet e Ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen.

NENI 12

Kuromi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

12.1 Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjete perqind)

te Kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30(tridhjete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaquesuar.

12.2 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat e permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise;
- (f) monitorimin dhe mbikqyryjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;
- (h) cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga ligi apo statuti.

12.3 Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjete perqind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30(tridhjete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme merren me voten pro te te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e ortakeve te pranishem apo te perfaquesuar.

12.4 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) ndryshimi apo plotesimi i Statutit te Shoqerise;
- (b) zmadhimi apo zgogrimi i kapitalit
- (c) shperndarjen e fitimeve vjetore nepermjet dividenteve dhe akordimin e aksioneve ne vend te dividenteve;
- (d) riorganizimin, shperndarjen, transformimin, bashkin, shkrirjen, ndarjen, likujdimin apo prishjen e shoqerise si edhe riorganizimin e shoqerise ne nje forme tjeter;
- (e) ndermarrjen e cdo veprimi i cili pitet ne menyre te arsyeshme se do te coje ne likujdimin e shoqerise;
- (f) hapjen e nje dege, blerjen apo shitjen e nje dege me ose pa emer;
- (g) marrjen persiper te cdo detyrimi me nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aktiveve totale te shoqerise sic rezulton nga pasqyrat e fundit financiare te audituara.

NENI 13 Administratori

13.1 Asambleja e Pergjithshme do te caktoje nje (1) personi fizik si Administrator te shoqerise, i cili mund te jete ortak ose jo dhe qe do te jete perqiegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

Administratori ushton keto detyra:

- (a) menaxhon shoqerine duke zbatuar politikat siç percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (b) sigurohet qe te mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;
- (c) Mban dhe nenshkuaran bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe ja paraqet ate Asamblese se Pergjithshme per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (d) krijon nje sistem paralajmerimi te hershem ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;
- (e) paraqet te dhenat e shoqerise per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas rastit;
- (f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per punen e Shoqerise;
- (g) cdo detyre tjeter siç percaktohet me ligj ose Statut.

13.2 Administratori emerohet per nje periudhe deri ne 5 (pese) vite dhe me te drejte rizgjedhjeje. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

13.3 Shoqeria merr angazhime me nenshkrimin e vetem te administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe ne kete Statut dhe Akt Themelimi.

13.4 Administratori i shoqerise ka te drejten dhe detyrimin per te perfaquesuar Shoqerine ne marredheniet me te tretet.

13.5 Asambleja e Pergjithshme emeron si Administrator te shoqerise, **Arb ABDYLI**, atësia Kastriot, amësia Venera, shtetas Kosovar, lindur në Prishtinë dhe banues në PRISHTINË, me adresë Rr. Arben Xheladini, nr 30, Prishtinë, lindur më 04/11/1999, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit Pasaporte Nr.PO2171893 leshuar nga shteti KOSOVË (RKS) date 16.06.2022 dhe date skadimi 15.06.2032, per nje afat 5 (pese) vjecar me te drejte rizgjedhje.

TITULLI V VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

NENI 14

Viti Financiar

14.1 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

14.2 Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) dhe perfundon me 31 Dhjetor te atij viti.

NENI 15 Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve

15.1 Permes vendimit te asamblese se pergjithshme shoqeria shperndan dividentin ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve, nese:

- a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimin e saj;
- b) shoqeria ka aktive likuide te mjastueshme per te paguar detyrimet qe duhet te jene te pagueshme brenda 12 muajsh.

15.2 Kapitalizimi i Fitimeve. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe ne lidhje me parimet e percaktuara ne nenin 14, te Ligjt 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund te vendose per te kapitalizuar fitimet.

TITULLI VI SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI

NENI 16

Prishja-Ndarja-Bashkimi

16.1 Shoqeria mund te prishet per shkaqet e parashikuara me ligj. Ne rast te prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emeron nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar kompetencat reciproke.

16.2 Shoqeria gjithashtu mund te ndahet ose te bashkohet me ane te nje vendimi te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve.

NENI 17 Likuidimi

17.1 Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet.

17.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emeron nje ose me shume likuidatore i cili do te hartoje raportin perfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqerise, si dhe procedurat dhe kohen e duhur per likuidim.

17.3 Ne fund te procedurave te likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.

17.4 Me likujdimin e kreditoreve likuiduesit gjithashtu do te shperndajne aktivet e mbetur te Ortakeve ne proporcione perqindjen qe ata disponojne.

TITULLI VII TE NDRYSHIME

A. A

NENI 18

Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Çdo mosmarreveshje ose mosmarreveshjet ndermjet ortakeve ose ne mes tyre ne Shoqeri fillimi do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe mëqesish. Nese, një zgjidhje mëqesore nuk mund te arrihet brenda 60 ditesh, çeshtja do t'i referohet Gjykatave te Tiranes, me një proces te rregullt që do te zhvillohet ne Tirane, Shqiperi.



DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Pergjegjesi te Kufizuar ROI Academy L.L.C sh.p.k, në prezencë të ortakut të vetem të shoqërisë, bazuar në vullnetin e lirë e të plotë të tij, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, nënshkruhet Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Pergjegjesi te Kufizuar ROI Academy L.L.C sh.p.k me adresë **Ruga Haxhi Hysen Dalliu, Hyrja 1, Nr.Pasurie 5/574+1-6, zk.8350, Vol.29, Fq.7, Tirane, Shqiperi** dhe Administrator z. **Arb ABDYLI**

Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Pergjegjesi te Kufizuar ROI Academy L.L.C sh.p.k, u hartua ne gjuhen shqipe, në 3 (tri) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike i përbërë nga 7 (shtatë) faqe

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Arb ABDYLI



Arb ABDYLI